

Nr. Prot. 007/B/16

Nr. i Regjistrimit: 30

RREGULLORE
PËR
REGJISTRIMIN E PARAPAGUESVE TË TELEFONISË MOBILE

Kjo Rregullore është nxjerr në bazë të nenit 10 paragrafi 4), nenit 67), paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si – Ligji*).

Neni 1
Qëllimi dhe Fushëveprimi

Kjo rregullore obligon ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile për regjistrim të parapaguesve para aktivizimit të shërbimit, si dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e parapaguesve dhe ofrueseve të këtyre shërbimeve.

Neni 2
Definicionet

Për qëllim të kësaj Rregulloreje;

- 2.1 Kuptimi apo definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje sipas Ligjit do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë Rregullore;
- 2.2 Termat dhe shprehjet në vijim do të kenë këtë kuptim:
 - a) **ARKEP** - nënkupton organin rregullator, i cili zbaton dhe mbikëqyrë kornizën rregullatore, e përcaktuara nga Ligji, nga Ligji për shërbimet postare, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe postare, të përcaktuara nga Qeveria, bazuar në dispozitat e paragrafit 1 të nenit 6 dhe paragrafit 1) të nenit 7 të Ligjit.
 - b) **Parapagues** - nënkupton çdo person fizik ose juridik, qe ka lidhur nje kontrate me nje ndërmarrës qe ofron shërbime te komunikimeve elektronike, te disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara
 - c) **SIM (Subscriber Identity Module) Kartele** - ID unike për një telefon, e cila vendoset brenda aparatit telefonik, dhe përmban informata personale për parapaguesit

përfshirë edhe aktivizimin në rrjet si dhe shënimet e numrave telefonik të parapaguesve.

- d) **Ofrues i shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile** - nënkupton çdo ndërmarrës që është i autorizuar nga ARKEP për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile të disponueshme për publikun (*tutje referuar si - ofrues i shërbimeve*).

Neni 3

Obligimet e parapaguesit-ëve

- 3.1 Obligohet që çdo parapagues qoftë person fizik apo juridik, pasi që të blejë SIM Kartelën të paraqitet në ndonjërin nga pikat e shitjes së ofruesit të shërbimeve, ose në ndonjë vend tjetër të përcaktuar nga ofruesi për të bërë aktivizimin e saj.
- 3.2 Pavaresisht nenit 3.1 personat fizik dhe juridik me parapagim mujor (post-paid) përjashtohen nga ky proces në qoftë se kontrata e lidhur i përmbanë të gjitha informatat e specifikuara në formularin e regjistrimit.

Neni 4

Kushtet për Regjistrim

- 4.1. Çdo person fizik mbi moshën 16 vjeçare, duhet të bëjë regjistrimin e SIM Kartelës personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar.
- 4.2. Regjistrimi për personat nën moshën 16 vjeçare duhet të bëhet nga ose në shoqërim të prindit/kujdestarit.
- 4.3. Regjistrimi për personat juridik duhet të bëhet nga përfaqësuesi ligjor/personi i autorizuar.

Neni 5

Informatat e Nevojshme për Regjistrim

- 5.1 Për regjistrimin e personave fizik ose juridik nevojiten këto informata:
- a) emri i plotë i parapaguesit, duke përfshirë edhe titullin akademik apo profesional të përdorur nga parapaguesi, nëse parapaguesi dëshiron ashtu;
 - b) emri i biznesit/institucionit të parapaguesit;
 - c) adresën e saktë të parapaguesit,
 - i. duke përfshirë dhe atë të selisë kryesore (nëse është e regjistruar jashtë vendit) e po ashtu edhe të filialit-degës të regjistruar në vendin tonë;
 - d) numri i identifikimit të parapaguesit;

- e) numri fiskal dhe numri i regjistrimit të biznesit për personin juridik dhe
- f) informata shtesë nëse parapaguesi pajtohet dhe personat e tretë nuk ndikohen nga këto informata.

Neni 6

Verifikimi i Informatave dhe Dokumentet e Nevojshme për Verifikim

- 6.1 Obligohen ofruesit e shërbimeve që para se të bëjnë regjistrimin të verifikojnë informatat e dhëna nga parapaguesi.
- 6.2 Për verifikim të informatave nevojitet njëra nga këto dokumente identifikuese:
 - a) Letërnjoftimi;
 - b) Pasaporta;
 - c) Patentë shoferi;
 - d) Autorizimi i vërtetuar nëse regjistrohet ndonjë person fizik ose juridik.
- 6.3 Të dhënat personale të përdorura nga ofruesit e shërbimeve gjatë regjistrimit të parapaguesve duhet të ruhen në përputhje me Ligjin për të dhënat personale.

Neni 7

Obligimet dhe të Drejtat e Ofruesve të shërbimeve

- 7.1 Ofruesit e shërbimeve janë të obliguar që të regjistrojnë të gjithë parapaguesit, pavarësisht a janë me kontratë apo të parapaguar para aktivizimit të shërbimit.
- 7.2 Ofruesit e shërbimeve nuk mund të regjistrojnë në emër të një personi fizik si parapagues më tepër se dhjetë (10) SiM kartela.
- 7.3 Numri i SiM kartelave të regjistruara në emër të personit juridik është i pakufizuar.
- 7.4 Obligohen Ofruesit e shërbimeve që të bëjnë aktivizimin e SIM Kartelës menjëherë pas kërkesës së parapaguesit por jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së saj, kurse në rast të mbingarkesave afati maksimal është 48 orë. Ky shërbim do të jetë pa pagesë.
- 7.5 Obligohen ofruesit e shërbimeve që mos të aktivizojnë numrat pa qenë të regjistruar më parë nga parapaguesit.
- 7.6 Ofruesit e shërbimeve mund t'i përdorin informatat mbi parapaguesit e tyre gjatë krijimit të kontratave, vendosjes së tarifës për shërbime, përgatitjes dhe publikimit të adresarëve për përdoruesit dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse.
- 7.7 Me kërkesë të parapaguesve Ofruesit e shërbimeve do të korrigjojnë, shtojnë, shlyejnë apo të rishkruajnë informatat dhe shërbimi do jetë pa pagesë. Informatat në adresarë

duhet të jenë të freskëta, dhe të dhënat në shërbimet ndihmëse për adresarë do të freskohen së paku 1 herë në muaj.

- 7.8 Parapaguesit, kanë të drejtë të vendosin nëse dëshirojnë të bëjnë publik numrat e tyre, emrat dhe adresat.
- 7.9 Obligohen ofruesit e shërbimeve që t'i dorëzojnë informata mbi regjistrimin e parapaguesve sa herë që ARKEP e sheh të nevojshme me qëllim të ushtrimit të aktivitetit të saj.

Neni 8

Ndryshimi i Parapaguesit/Humbja e SIM Kartelës/Vjedhja

- 8.1 Obligohet parapaguesi që në rast të shitjes/tjetërsimit të SIM Kartelës ai duhet të njoftojë me shkrim në ndonjërin nga pikat e shitjes së ofruesit të shërbimit dhe parapaguesi i ri i SIM kartelës të ofroj shënimet e tija për regjistrimin e SIM kartelës si parapagues i ri. Pas kësaj ofruesi i shërbimit do të bëjë regjistrimin e parapaguesit të ri.
- 8.2 Në rast të ndryshimit të parapaguesit, ofruesi i shërbimit obligohet që të mbajë të dhënat për dy (2) vitet e ardhshme pas ndryshimit të parapaguesit.
- 8.3 Në rast të humbjes së SIM Kartelës ose dyshimit për vjedhje të saj, parapaguesi duhet që menjëherë të lajmërojë Ofruesin e shërbimit, i cili obligohet që menjëherë të bëjë ndërprerjen e përkohshme të shërbimit.
- 8.4 Ofruesit e shërbimeve përpara se të bëjnë ndërprerjen e përkohshme të shërbimit duhet të bëjnë verifikimin e parapaguesit.
- 8.5 Shërbimi do të qëndrojë i ndërprerë për aq kohë sa nuk kërkon parapaguesi të bëjë aktivizimin e sërishëm të SIM Kartelës, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e ndërprerjes së përkohshme.

Neni 9

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

- 9.1 Të gjithë ofruesit e shërbimeve obligohen të njoftojnë parapaguesit e tyre, të cilët kanë më tepër se dhjetë (10) SIM kartela të regjistruara në emër të një personi fizik.
- 9.2 Të gjithë parapaguesit aktual, të cilët janë persona fizik dhe kanë më tepër se dhjetë (10) SIM kartela në emrin e tyre obligohen që të bëjnë çregjistrimin e SIM Kartelave të tyre brenda periudhës prej 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
- 9.3 Në rast të mos-veprimit në përputhje me këtë nen, ofruesit e shërbimeve obligohen të de-aktivizojnë numrat përkohësisht dhe lejojnë një afat shtesë prej 30 ditësh, me çrast do të njoftojnë parapaguesit e tyre se pas përfundimit të këtij afati shtesë ofruesi i shërbimit rezervon të drejtën e ri-shitjes së numrave.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

- 10.1 Kjo rregullore hynë në fuqi me datën e nënshkrimit të saj.
- 10.2 Kjo rregullore shfuqizon rregulloren Nr.81/1/10 për regjistrimin e përdoruesve të telefonisë mobile.
- 10.3 Aneksi 1 i kësaj Rregulloreje është Formulari për Regjistrimin e Parapaguesve të SIM Kartelave.

Prishtinë, 25 Janar, 2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

ANEKSI 1
Formulari për regjistrimin e parapaguesve të telefonisë mobile